

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			CAA
Nr. i prot.	2022/ZOP/380		
Br. prot./Prot.Nr.			
Faqe: 2	Kopje: ARKIV	Datë: 12/12/2022	
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date	
Hyrës/ulazno/in	<input type="checkbox"/>		
Dalës/izlazo/out	<input checked="" type="checkbox"/>		
Brendshëm/interno/internal	<input type="checkbox"/>	Prishtinë/Prishtina/Pristina	

10/ZDP/VE/2022
Datë: 12 dhjetor 2022

Në mbështetje të nenit 15.1 (d), nenit 21 paragrafi 2 dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 4 qershor 2008), të ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 30/2022, dt. 5 shtator 2022), në përputhje me Rregulloren e AAC-së 05/2015 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil, me ndryshime,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr:

VENDIM

1. Autorizohet Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës me adresë rr. Nena Terezë p.n. 50000 Gjakovë, si Qendër e Mjekësisë së Aviacionit (QMA) në Republikën e Kosovës për një periudhë prej 6 muajsh me qëllim të realizimit efektiv të interesit publik dhe ofrimit të shërbimit publik me interes të përgjithshëm.
2. Ky autorizim kufizohet në zbatimin e kompetencave ligjore të QMA, në ofrimin e shërbimeve të ekzaminimeve mjekësore për personelin e aviacionit civil që i nënshtrohen licencimit nga AAC.
3. Obligohet QMA që brenda periudhës së vlefshmërisë të këtij autorizimi ta trajtojë udhëheqësin e AMA-së në fushën e mjekësisë së aviacionit me qëllim të përmbushjes së kërkesave për certifikim të QMA-së në përputhje me Rregulloren 05/2015 e cila përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil, me ndryshime.
4. Si masë e përkohshme obligohet QMA që gjatë ofrimit të shërbimeve të ekzaminimeve mjekësore të parashikuara me legjislacionin përkatës të aviacionit civil t'ju ofroj qasje të pakufizuar Ekzaminuesve të Autorizuar Mjekësor (EAM), të AAC-së, në pajisjet mjekësore, procesin e ekzaminimit dhe dosjet mjekësore të personelit të aviacionit, duke mbrojtur gjatë gjithë kohës parimin e konfidencialitetit të të dhënave mjekësore.

5. Personeli i aviacionit që shfrytëzon shërbimet e QMA-së duhet të paguaj për shërbimet e të gjitha ekzaminimeve të nevojshme mjekësore, në përputhje me Udhëzimin Administrativë Nr. 04/2007 të Ministrisë së Shëndetësisë.
6. Për lëshimin e këtij Vendimi nuk paguhet tarifë nga QMA.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është i vlefshëm deri më 12 qershor 2023.



Iu dërgohet:

- Qendrës Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë;
- Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve, AAC;
- Arkivit të AAC-së.